

EPPC Albania në kuadër të zgjerimit të aktiviteteve të saj, po kërkon një **Trajnues/e**.

## Përgjegjësitë Kryesore:

1. Identifikon dhe vlerëson nevojat aktuale dhe potenciale për trajnime përmes analizave, vlerësimeve vjetore të performancës dhe konsultimeve me menaxherët;
2. Zbaton kërkesat për trajnime që do të dhurojnë mbështetje për punonjësit në zhvillimin e tyre personal dhe kryen trajnime efektive mbi temat “*soft skills*”;
3. Përpilon një plan trajnimi dhe zhvillimi të përgjithshëm apo të individualizuar që adreson nevojat dhe pritjet e punonjësve dhe biznesit;
4. Monitoron dhe vlerëson efektivitetin, suksesin dhe benefitet e programit të trajnimit në mënyrë periodike dhe bën raportimin e tyre;
5. Zhvillon ose mbikëqyr prodhimin e materialeve të nevojshme të trajnimit;
6. Përditësohet me trendet dhe mjetet e reja të trajnimit dhe zhvillimit të punonjësve dhe i zbaton ato gjatë trajnimeve.

## Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare;
- Kualifikime dhe eksperiencia të mëparshme në këtë pozicion;
- Njeh metodat, mjetet dhe teknikat tradicionale dhe moderne të trajnimit;
- Aftësi për të paraqitur informacion kompleks për audiencë të ndryshme;
- Aftësi e provuar për të prezantuar dhe për të zotëruar ciklin e plotë të trajnimit;
- Aftësi të mira komunikuese dhe shkathtësi ndërpersonale;
- Personalitet i përkushtuar që punon në një mjedis dinamik;
- Të jetë person energjik dhe karizmatik në zhvillimin e trajnimit;
- Njohuri e mirë e MS Office (PowerPoint në veçanti);
- Të zotërojë gjuhën angleze.

## Të dhënat:

<b>Pozicioni:</b>	Trajnues/e;
<b>Vendndodhja:</b>	Tiranë (Zona e Liqenit Artificial);
<b>Orari:</b>	40 orë në javë;
<b>Kontrata:</b>	Sipas Ligjit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	07.06.2018

## Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke ***përmendur pozicionin për të cilin aplikoni*** në adresën e e-mail-it:

[recruitments@eppc.al](mailto:recruitments@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.